



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 1900 Prot

Gjirokastrë, më 10.12. 2024

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA

Lënda: Hapen thirrjet për shkrim projekt propozimesh në kuadër të programeve të financimit për vitin 2025 në Shqipëri nga Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit .

Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka hapur thirrje të reja për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Projekt - propozime të kërkimit dhe zhvillimit (PKKZH) në kuadër të programeve kombëtare për vitin 2025	30 janar 2025
2	Aplikim për projekte të infrastrukturës së kërkimit shkencor (PIKSH) për vitin 2025	15 janar 2025
3	Projekt - propozime në kuadër të programeve kombëtare të teknologjisë dhe inovacionit (PTI) për vitin 2025	20 janar 2025

1. Projekt - propozime të kërkimit dhe zhvillimit (pkkzh) në kuadër të programeve kombëtare për vitin 2025

Kjo është një thirrje për propozime për projekte të kërkimit shkencor e financuar nga “Programi i financimit të kërkimit shkencor, menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI”, për vitin 2025.

Qëllimi i thirrjes është mbështetja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushat prioritare, përmes financimit me grante të projekteve në kuadër të programeve kombëtare, të propozuara nga kërkues shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë ose institucione të tjera që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor.

Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe shkencat mjekësore
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

2. Aplikim për projekte të infrastrukturës së kërkimit shkencor (PIKSH) për vitin 2025

Përmes kësaj thirrjeje do të mbështeten financiarisht projekt-propozime nga institucionet publike të arsimit të lartë publik që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor.

Projekt-propozimi duhet të mbështetet në prioritetet strategjike sektoriale të miratuara nga qeveria shqiptare sipas fushave përkatëse si dhe duhet të argumentojë ndikimin që do të ketë infrastruktura e kërkuar në arritjen e objektivave të politikës, strategjisë e misionit të IAL-së.

3. Projekt - propozime në kuadër të programeve kombëtare të teknologjisë dhe inovacionit (PTI) për vitin 2025.

Kjo thirrje është hapur për Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI), (bashkëpunimi i IAL-ve me biznesin).

Qëllimi i thirrjes është mbështetja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushat prioritare, përmes financimit me grante të projekteve në kuadër të programeve kombëtare, të propozuara nga kërkues shkencorë në IAL ose institucione të tjera që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor.

Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe shkencat mjekësore

- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin zyrtar të Agjensisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI): (<https://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare-2/>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj

